

# RELACION

## PËR

### AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT 2021””

#### A. MËNYRA E NDËRHYRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë<sup>1</sup>:

1. *Nevoja* dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

#### **1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:**

Neni 101 ka parashikuar ‘**nevojën**’ dhe ‘**urgjencën**’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në shkresën e KQZ-së nr.485, datë 20.1.2021, përmes së cilës ka marrë dijeni mbi kërkesën për fonde shtesë në masën rreth 2.42 miliardë lekë (me TVSH), me qëllim financimin e projektit “*Identifikimi elektronik i zgjedhësve*”, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2021.

Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet pikërisht me nevojën imediate për financimin e projektit madhor të KQZ-së “*Identifikimi elektronik i zgjedhësve*”, në kuadër të angazhimit të ndërmarrë nga qeveria për implementimin e tij në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

## 2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

## B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV

Referuar sa më sipër, akti normativ përcakton ndryshime pa kosto shtesë në:

- **Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm** – Përmes alokimit të fondit shtesë prej 2.42 miliardë lekësh, për financimin e projektit madhor të KQZ-së “Identifikimi elektronik i zgjedhësve”, në kuadër të angazhimit të ndërmarrë për implementimin e tij në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
- **Fondin rezervë të Këshillit të Ministrave** – Përmes rritjes me 1 000 milionë lekë të tij, në kuadër të shpenzimeve eventuale shtesë që mund të burojnë nga implementimi i përcaktimeve të Kodit të Ri Zgjedhor, lidhur me zgjedhjet për Kuvend të datës 25.4.2021, si edhe për përballimin e shpenzimeve të tjera eventuale të qeverisë;
- **Të ardhurat tatimore** – Përmes shtimit në të njëjtën vlerë, pra 3.42 miliardë lekë, të nivelit të planifikuar të të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).

## C. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV

KQZ-ja, përmes shkresës nr.485, datë 20.1.2021, i ka paraqitur Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kërkesën për fonde në masën rreth 2.42 miliardë lekë (me TVSH), me qëllim financimin e projektit “Identifikimi elektronik i zgjedhësve”, duke na vënë në dijeni se:

Karakteristikat bazë të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, që do të përdoren për identifikimin elektronik të zgjedhësve në zgjedhjet e datës 25 prill 2021, u miratuan nga Komisioni Rregullator i KQZ-së me vendimin nr.2, datë 31.10.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”.

KQZ-ja në datën 14 janar 2021 përfundoi fazën e vlerësimit të ofertës dhe zgjedhjes teknike të paraqitur nga kompania *Smartmatic International Holding B.V*, me vlerë: 19 975 774 USD (pa TVSH) dhe e konvertuar në lekë referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për datën 23.12.2020, me vlerë 2 016 354 627 lekë (pa TVSH). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas shyrimit të dokumentacionit, ofertës ekonomike dhe zgjedhjes teknike të operatorit ofertues, vendosi kualifikimin e ofertës së *OE Smartmatic International Holding B.V*.

Aktualisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në përfundim të dakordësimit për termat dhe nënshkrimin të kontratës me operatorin fitues, që do të pasojë me procesin përgatitor për implementimin e sistemit për projektin “Identifikimi elektronik i zgjedhësve”.

Ndërkohë, në zbatim të nenit 70, të vendimit nr.914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të lidhë kontratën me operatorin fitues vetëm pasi fondet buxhetore të jenë në dispozicion.

Në këto kushte, KQZ-ja kërkon akordimin e fondeve të nevojshme prej 2 419 625 522 lekësh (vlera totale e prokuruar) për lidhjen e kontratës për projektin “Identifikimi elektronik i zgjedhësve”. Në këtë fond përfshihet edhe vlera e TVSH-së si edhe detyrime të mundshme doganore.

Nisur nga rëndësia madhore e projektit në fjalë, dhe duke konsideruar pamundësinë e financimit të tyre nga buxheti i KQZ-së i miratuar për vitin 2021 dhe/ose rezerva të tjera të buxhetit të shtetit, propozojmë përballimin e kostos totale të projektit strategjik në fjalë, përmes këtij rishikimi të ligjit të buxhetit të miratuar për vitin 2021.

Në përfundim, është me rëndësi të theksohet se ky akt normativ nuk prek parametrat kyç makrofiskal, siç janë deficitit buxhetor dhe borxhi publik, të cilët mbeten të pandryshuar.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**